



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 53 Prot.

Tiranë, më 09 / 07 / 2020

VENDIM

Nr. 20, Datë 09.07.2020

PËR  
MIRATIMIN E FORMATIT TË FLETËS SË VOTIMIT NË UNIVERSITETIN E  
MJEKËSISË, TIRANË

Në bazë të Rregullores së Zgjedhjeve miratuar nga Senati Akademik i UMT-së me Vendimin nr.13, datë 12.02.2020 "Për miratimin e Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë", përkatësisht neni 31, Komisioni Institucional Zgjedhor, në mbledhjen e datës 09.07.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e formatit të fletëve të votimit për personelin akademik:
  - Fletë votimi për Rektor
  - Fletë votimi për drejtues të njësisë kryesore (Dekan)
  - Fletë votimi për drejtues të njësisë bazë/qendrës së kërkimit shkencor (Përgjegjës Departamenti)
  - Fletë votimit për anëtar të Senatit akademik nga personeli akademik
2. Miratimin e formatit të fletëve të votimit për studentë:
  - Fletë votimi për Rektor
  - Fletë votimi për drejtues të njësisë kryesore (Dekan)
  - Fletë votimi për anëtar të Senatit akademik nga studentët
3. Fletët e votimit do të kenë specifikimet e mëposhtme:
  - a. Lloji i fletës: Fletë votimi të prodhuara në blloqe pa kundërfletë, watermark 90 gr/m2 pulp, me fibra karboni ultraviolett, 2 shtresa, e ratifikuar në fazën përfundimtare, i vazhdueshëm me skicë speciale, me mikroprintime
  - b. Dimensionet: gjerësia e fletës 210 mm, gjatësia e fletës 297 mm
  - c. Specifikime në përmbajtje të fletës së votimit: çdo fletë votimi ka ngjyrën e vet sipas formateve bashkëlidhur, logo e universitetit me përmasa 17 mm x 40 mm e printuar me

ngjyrën e fletës së votimit, shtypi në 3 ngjyra (sfond, nr.serial, shkrimi), në sipërfaqen e formatit në të dy anët do të shtypet një mikroprintim i cili nuk shihet me sy të lirë por përmes një lente optike. Në fletën e votimit do të shtypet me bojë ultraviolet të padukshme logoja e universitetit UMT zgjedhje 2020. Ky është element sekret konfidencial dhe kontrollohet vetëm nëpërmjet llampës ultraviolet. Çdo fletë votimi do të ketë numrin e vet serial (unik)

4. Numri i fletëve të votimit (rreth 21000), formatet për printim, miratohen me një vendim të posaçëm të KIZ
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, afishohet në ambientet e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT-së dhe një kopje e tij i dërgohet Administratorit të UMT.

KRYETAR  
SILVANA BALA



Anëtarët:

IRENA SEFERI  
ALBANA BANUSHI  
MIGENA GEGA  
NIKO HYKA  
ANDIS QENDRO  
DEA CENOMERI